



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:043343

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05489990

KF.nr.106/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULLI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit E.D. , Ortak i Comtrade Computers O.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.A., kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 2,482.14 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit I.A., dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 14.03.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.D., Ortak i Comtrade Computers O.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.A..
- II. ANULOHET PJESËRISHT vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.593/2019 i datës 21.02.2020, dhe atë vetëm në pjesën që i referohet TVSH-së për periudhën 2017-2018, për vitin 2017 shumën prej 1,799.02 €, dhe për vitin 2018, shumën prej 683.12 €, në total shumën prej 2,482.14 €.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit E.D. , Ortak i Comtrade Computers,O.K., me seli në Prishtinë, të ia kthej shumën e mjeteve të paguara më tepër në vlerë prej 2,482.14 €, në emër të TVSH-së për vitin 2017 dhe 2018, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. MBETËT NË FUQI Vendimi i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.593/2019 i datës 21.02.2020, në pjesës jo kontestuese përtej shumave të gjykuara si më lartë, dhe atë sipas Raportit të Kontrollit nr. 81 të datës 20.11.2019, të vërtetuar me vendimin nr.593/2019 i datës 21.02.2020.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.593/2019 i datës 21.02.2020. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor – kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse deklaroi se në emër të paditësit E.D., deklaroi se qëndrojmë mbrapa kërkesave tona, por njëkohësisht pajtohemi me vlerësimin e ekspertizës financiare dhe plotësimin e saj. Bëjë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që: kërkojë që të aprovohet padia si e bazuar, vendimi kontestues të anulohet pjesërisht dhe atë për shumën si në vijim: për vitin 2017 në lartësi prej 1,799.02 € dhe për vitin 2018 shumën prej 683.12 €, te obligohet e paditura ATK që këtu paditësit ti a kthejë shumat e paguara më tepër dhe atë për vitin 2017 në lartësi prej 1,799.02 € dhe për vitin 2018 shumën prej 683.12 €, në total shumën prej 2,482.14 €, ndërsa pjesa tjetër përtej këtyre shumave tanimë mbetet jo kontestuese dhe të njëjtën e pranojmë sipas vlerësimeve të ATK-ës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 15.07.2021 i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pa bazuar në ligj dhe fakte materiale, duke vlerësuar se vendimi i kontestuar i ATK-së, ka mbështetje ligjore dhe faktike si në shkresat e lëndës dhe është në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor e njëjta nuk ka prezantuar, e cila me parashtresën e datës 07.03.2024, i ka paraqitur pretendimet e saja, përkitazi me Ekspertizën Financiare si dhe plotësimin e saj, e njëjta ka deklaruar se i kundërshton në tërësi, meqë të njëjtat bazohen vetëm në një anë të medaljes, e po ashtu konsideron si të vetmin dokument burimor e valid të dhënat që shkojnë në favor të paditësit, pa marrë parasysh edhe faktet, rrethanat dhe dokumentacionin kontabël në bazë të së cilës ka vendosur meritorisht e paditura ATK, rrjedhimisht, duke mos vlerësuar drejtë dhe saktë lidhur me përcaktimin zyrtar të ATK-së, meqë bazuar në faktet dhe dëshmitë e ofruara, paditësi nuk ka ofruar prova që ATK të i jepte mundësinë të vepronte ndryshe nga përcaktimi zyrtar si në kontroll dhe në vendimin ku konstatohen dhe vërtetohen në mënyrë të argumentuar të gjitha të gjeturat e ekzaminimit tatimor të kryer të paditësit. ATK mbetet në tërësi sipas sqarimeve dhe argumenteve të paraqitura si në përgjigje në padi si dhe konstatimeve në përcaktimin zyrtar të ATK-ës, e të argumentuar dhe konstatuar po ashtu në vendimin e kontestuar nga paditësi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi

593/2019 i datës 21.02.2020, njoftim ri vlerësimet, raporti i kontrollit nr.81 i datës 20.11.2019, ankesa e ushtruar në ATK, përgjigja në padi e datës 15.07.2021, vendimi 2234/2019 i datës 21.11.2019, vendimi 552/2019 i datës 14.02.2020, ekspertiza financiare e datës 23.02.2023, tabela e produkteve të vitit 2017 së bashku me tabelën më shpjegime përkatëse, tabela e produkteve të vitit 2018 së bashku me tabelën më shpjegime përkatëse, parashtrësja e ATK-ës e datës 30.01.2024, plotësim ekspertiza financiare e datës 25.02.2024, deklaratë e tatimit në të ardhura nga ortakëria për vitin 2017-2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, Raportit të kontrollit nr.81 i datës 20.11.2019, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti subjekti E.D., Ortak i Comtrade Computers O.K, me seli në Prishtinë, nga e paditura ATK-ë i është nënshtruar kontrollit ku objekt i kontrollit ka qenë PD-2017 dhe 2018, si dhe TVSH 01/2017 deri më 05/2019, si dhe ndryshimet pas përfundimit të kontrollit shtesë 01.01.2017 deri me 31.12.2018. Po ashtu, nuk është kontestuese as fakti se subjekti në procedurë ka ushtruar ankesë pranë Departamenti të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me datën 21.02.2020 ka marrë vendimin nr.593/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e subjektit tatimor, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 09.04.2020, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave në shkallë të dytë e ka aprovuar pjesërisht ankesën e subjektit tatimor këtu paditësit, ka ndryshuar njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë për periudhat tatimore PD/2017 dhe PD/2018, dhe ka anuluar pjesërisht vendimin nga Zgjonja nr.2234/2019 të datës 21.11.2019 në lidhje me ndëshkimet administrative për mos krijim dhe mos mbajtje të dokumentacionit në vlerë prej 2 x 250.00 €, me arsyetim se do të bëj

harmonizimin me Deklaratat e Ortakërisë “Comtrade Computers” OK, për periudhat DO/2017 dhe DO/2018 ku fitimet neto sipas Njoftim Rivlerësimeve të lëshuara nga Divizioni i Ankesave do ta shpërndaj sipas përqindjes së pjesëmarrjes në periudhat respektive PD/2017 dhe PD/2018. Tutje ka theksuar se sa i përket vendimit nga Zgjhona nr.2234/2019 të datës 21.11.2019 për ndëshkimet Administrative për mos mbajtje dhe mos krijim të regjistrimeve bazuar në nenin 53 paragrafi 2 të Ligjit nr.03L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat në vlerë totale prej 3,760.82€. Divizioni i Ankesave vendos se bazuar në dispozitat ligjore të nenit 42 paragrafi 4 i Ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale përkatësisht nenin 43 paragrafi 5 i UA nr.01/2016 parasheh *“Nëse ortakët apo anëtarët e grupi, përveç të ardhurave nga ortakëria apo grupimi i personave, realizojnë edhe të ardhurat tjera jashtë ortakërisë apo grupimit personal, obligohen të mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me nenin 33, paragrafi 5 të Ligjit”*, ndërsa në rastin konkret nga shkresat e lëndës nuk mund të provohet se ortakët përkatësisht E.D. nuk realizon të ardhurat tjera nga jashtë, ortakëria atëherë nuk obligohet në mbaj libra dhe regjistrime në përputhje me nenin 33 paragrafi 5 të Ligjit nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Divizioni i Ankesave ka vendosur që ta liroj tatimpaguesin nga ndëshkimet administrative për mos mbajtje dhe mos krijim të regjistrimit bazuar në nenin 53 paragrafi 2.2 të Ligjit nr.03/L-222, në vlerë totale prej 500.00 (2x250.00) të cilat i ka vërtetuar si të pa bazuar.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.106/22 të datës 05.12.2022 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar gjyqësor SH.B., me detyrat përkatëse.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 23.02.2023 dhe plotësim ekspertizën financiare të datës 25.02.2024, sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 14.03.2024, nga ana e ekspertit financiar SH.B., për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendimi dhe konstatimi se: *“Eksperti financiar gjyqësor, pas rishikimit të gjendjes së vërtetuar me Ekspertizën bazë të datës 23.02.2023, dhe duke paraqitur gjendjen nga të gjeturat sipas raportit të kontrollit për tatimin PD për vitet 2017 dhe 2018, ndryshimet nga departamenti i ankesave i ATK-ës dhe të gjeturat sipas ekspertizës financiare, ka ardhur në përfundim se: për vitin 2017 Nga pasqyra e të ardhurave E.D. / Nr.fiskal 60018776 , Raporti i Kontrollës ka rritë shumën e qarkullimit shtesë nga 79.203.25. Nga rregullimet e zërave të kësaj pasqyre, rrjedhë shuma obligative për pagesë në vlerë prej 3,155.26 €, Nga Departamenti i Ankesave, ka ulë në shumën e qarkullimit shtesë*

*nga 79,203.25 € , në 69,759.70 €, Nga rregullimet e zërave të kësaj pasqyre , rrjedh shuma obligative për pagesë në vlerë prej 2,211.26 €, 3. Sipas Raportit të ekspertit shuma e qarkullimit shtesë prej 51,776.49 €, Nga rregullimet e zërave të kësaj pasqyre, rrjedh shuma obligative për pagese ne vlere prej 412.24 €. Ndërsa për vitin 2018 Nga pasqyra e të ardhurave E.D. /Nr.fiskal 60018776 , Raporti i Kontrollës ka rritë shumën e qarkullimit shtesë nga 14,686.32 €. Nga rregullimet e zërave të kësaj pasqyre, rrjedhë shuma obligative për pagesë në vlerë prej 7,915.23 €, Nga Departamenti i Ankesave, ka ulë në shumën e qarkullimit shtesë nga 145,686.32€, në 135,947.18€, Nga rregullimet e zërave të kësaj pasqyre , rrjedh shuma obligative për pagesë në vlerë prej 6,941.32€, 3. Sipas Raportit të ekspertit shuma e qarkullimit shtesë prej 129,205.99€, Nga rregullimet e zërave të kësaj pasqyre, rrjedh shuma obligative për pagese ne vlere prej 6,258.20 €.*

Pala e paditur me parashtrësën e datës 07.03.2024 e ka kundërshtuar ekspertizën financiare dhe plotësimin e saj.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare dhe plotësimin e saj të punuar nga eksperti financiar SH.B., në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Eksperti financiar në seancë e shqyrtimit gjyqësor-kryesor të datës 14.03.2024 ka theksuar se mbetëm në tërësi në plotësim ekspertizën të datës 25.02.2024, detyrën e marrë nga gjykata e kamë përfunduar në tërësi dhe të njëjtën e kam paraqitur në faqen e fundit tek mendimi dhe konstatimi ne faqen numër 7 te plotësim ekspertizës financiare dhe sipas zërave për vitin 2017-2018 kemi këtë gjendje: për vitin 2017 tatimi i kalkuluar nga Departamenti i Ankesave i ATK-ës është në shumën prej 2,211.26 €, ndërsa sipas të gjeturave të mija në ekspertizë duhet të jetë shuma prej 412.24 € dhe diferenca ndërmjet këtyre dy vlerave e cila është në shumën prej 1,799.02 paraqet lartësinë e mjeteve të paguara më tepër. Për vitin 2018 tatimi i kalkuluar nga Departamenti i Ankesave i ATK-ës është në lartësi prej 6,941.32 €, ndërsa tatimi sipas vlerësimit tim si ekspert për këtë periudhë duhet te jete në shumën prej 6,258.20 € dhe ndryshimi ndërmjet këtyre dy vlerave në lartësi prej 683,12 €, paraqet mjetet e paguara më tepër nga paditësi për këtë periudhe. Ne total këto dy shuma kapin vlerën prej 2,482.14 €.

Gjykata ka gjetur se mungesa e mallrave është konstatuar dhe prezantuar fillimisht ne Raportin e Kontrollit të subjektit Comtrade Computers të datës 30.10.2019, pastaj, nga ky raport bazë i

kontrollit, është ndarë mungesa e mallrave ne nivelin 50% (për pjesën e ortakut) ku ka reflektuar në Raportin e Kontrollit të ortakut E.D., të datës 20.11.2019. Analizat detale materiale e evidentuar në paragrafin 4.5 të raportit të kontrollit, është e dokumentuar me kartelat e mallit dhe faturat përcjellëse që paraqesin lëvizjet e mallit, së bashku me faturat përcjellës të cilat janë të evidentuara në librin e blerjes, e të cilat inspektori dhe divizioni i ankesave i ATK-së, nuk i ka marrë në shqyrtim, përfshirë edhe dokumentacionin intern të lëvizjes së mallrave „depo-montim-depo” dhe përfshirjes së produkteve „depo-montim-depo” në produkt të ri të krijuar, shitjen përkatësisht përgatitjen e kompjuterëve sipas kërkesave së klientëve, dhe për këtë arsye është konstatua mungesë e mallrave në depo. Procesi i montimeve të ndryshme të pajisjeve ka shkaktuar paqartësi gjatë gjetjes së sasive reale të mallrave në depo, përkatësisht paraqitjes së mungesave të disa produkteve, fakte këto të konstatuara edhe me ekspertizë financiare.

Tutje gjykata ka konstatuar se mungesat e mallrave janë edhe si rezultat i lëshimeve gjatë shitjes, kur mes shumë produkteve të një kategorie në shitore, palët kane zgjedhur produktin adekuat të cilëve ata kane konsideruar si të nevojshëm, p.sh. disqe SSD 250 të prodhuesve të ndryshëm, modeleve të ndryshëm, ose e kanë të shënuar kapacitetin 256GB. Këto raste do të konsiderohen varësisht nga stoqet/rezervat si mungesa/teprice e mallrave. Nëse palës i jepet disku i një prodhuesi, kurse gjatë përpilimit të faturës nëse gabimisht është zgjedhur i prodhuesit tjetër, njëri disk do të paraqitet me teprice, kurse tjetri do të jetë me mungesë në sasi. Ngjashëm ndodhë edhe me shumë produkte tjera, ku më së shumti janë të shprehur tek memoriet, kabllot me ngjyra të ndryshme etj.

Si përfundim, gjykata vlerëson se mungesa e mallit të konstatuar në raport mund të grumbullohen ne dy pozicione: Produktet e modifikuara para shitjes, ku blerësit e pajisjeve kompjuterike kanë pasur kërkesa të ndryshme, andaj edhe Kompania „Comtrade Computers” para shitjes disa prej tyre i ka modifikuar në servis. Për këtë qëllim, janë krijuar dy dokumente interne ku prej depos i jepen servisit mallrat që përfshihen në modifikim, dhe kur në depo kthehen mallrat e modifikuar, dhe produktet që paraqiten si mungesa për shkak të gabimeve teknike në depo dhe gabimeve gjatë shitjes.

Nga shqyrtimi i analizës materiale për vitin 2017 dhe 2018, vërtetohet se duhet të eliminohet qarkullimi shtese në TVSH-ë 12/2017 në total prej 35,966,43 €( shitje me TVSH-ë 18% ne vlere prej 14,082,00 € dhe shitje me TVSH-ë 8% ne vlere prej 21,884,45 €). Nga pjesa prej 35,966,43

€ , 50% i takojnë Aksionarë: E.D. ne shume prej 17 983,21 €. Qarkullimi shtesë në TVSH-ë 12/2018 ne total prej 13,482,19 € ( shitje me TVSH 18% në vlerë prej 4 498,35 € dhe shitje me TVSH 8% në vlere prej 8 983,85 €). Nga pjesa prej 13 482,19 €, 50% i takojnë Aksionarë: E.D. në shume prej 6,741,09 €. Në deklarin e TVSH-së për muajin qershor 2018, të dhënat janë në pajtueshmëri me raportin të kontrollit të datës 20.11.2019 te kolona nr. 9: Shitjet e liruara pa të drejtë kreditim, është vlere prej 309.000,00€, që paraqet çmimin e tokës së shitur dhe në kolonën nr.12: Shitjet e tatueshme me normën 18%, paraqesin vlerën e objektit prej 439.696,04 € qe i nënshtrohet 18% TVSH se llogaritur, te cilat janë marrë nga Kontrata e Shitblerjes se Paluejtshmërise dhe Objektit në Ndërtim e sipër me Ref.nr. 841/2018 të datës 26.06.2018.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore, për t'ia kthyer paditësit shumat e paguara më tepër për vitin 2017 në lartësi prej 1,799.02 € dhe për vitin 2018 shumën prej 683.12 € në total prej 2,482.14€. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par. 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e anuloi pjesërisht vendimin e kontestuar, duke e obliguar të paditurën që paditësit të ia kthej shumat e paguar më tepër në shumë prej 2,482.14 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”*, paragrafi 2. *“Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”*. Paragrafi 3. *“Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”*, paragrafi 4. *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, dhe paragrafi 5. *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*.

Lidhur me pjesën tjetër përtej këtyre shumave i ka lënë në fuqi sipas raportit të Kontrollit nr.81 të datës 20.11.2019 të Administratës Tatimore të Kosovës, të vërtetuar me vendimin kontestues

nr.593/2019 të datës 21.02.2020, kjo për faktin se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e datës 14.03.2024 në precizimin e kërkesëpadisë ka propozuar që përtej këtyre shumave tanimë mbetet jo kontestuese dhe të njëjtën e ka pranuar sipas vlerësimeve të ATK-së. Pra, në rastin konkret paditësi të njëjtat i ka bërë si jo kontestuese dhe se për të njëjtat ka pranuar edhe të gjeturat nga plotësim financiarë, andaj edhe gjykata nuk është lëshuar më tej në elaborim dhe vlerësim të të njëjtave.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjkata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, Gjkata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal  
KF.nr.106/22, datë 14.03.2024

Zyrtare Ligjore  
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i  
Fisnik NULI

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.